



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:183962

Datë: 30.11.2023

Numri i dokumentit: 04994817

PPP.nr.176/2019

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË I, DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM, me gjyqtaren Pajtesë Boshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit K.R.M AMBIENTI SH.A njësia operative I., ndaj debitorit autolarje H.F nga fshati G. Komuna I., në bazë të dokumentit të besueshëm ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat për bartjen e mbeturinave, baza juridike borxh në shumë prej 412.00 €, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit kundër urdhrorit të Përmbauesit Shpend Ahmetaj në Pejë P.nr.680/19 të datës 12.11.2019, jashtë seancës gjyqësore me datë 29.11.2023 bie këtë:

A K T V E N D I M

I.PRANOHET PJESËRISHT I BAZUAR, prapësimi i debitorit H.F nga fshati G. Komuna I., i parashtruar kundër urdhrorit të Përmbauesit Privat Shpend Ahmetaj në Pejë P.nr.680/19 të datës 12.11.2019, dhe atë për vlerën e borxhit në shumë prej 298.60 €.

II.REFUZOHET SI I PABAZUAR, prapësimi për pjesë tjetër të detyrimit në të holla në shumën prej 113.40 €, të cilin detyrim në të holla obligohet pala debitore që ta përmbush ndaj kreditorit.

III. Në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi Urdhërohet që në afatin prej 7 (shtatë) ditësh të paguaj garancinë në gjykatë në shumë prej 113.40 euro.

IV. Nëse debitori dështon të paguaj shumën e garancisë brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A R S Y E T I M

Kreditori, ka parashtruar propozim për lejimin e përbarimit të Përmbauesi Privat ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve për bartjen e mbeturinave, për periudhën kohore nga data 01.05.2013 deri me datë 30.09.2019, baza juridike borxh në shumë prej 412.00 €. Përmbauesi privat duke

vendosur në bazë të propozimit të kreditorit me datë 12.11.2019 ka caktuar urdhërin për përmbarim. Debitori, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar prapësim kundër këtij urdhri përmbarimor duke u thirr në parashkrimin e borxhit, konform dispozitave të LMD-së. Kreditori në afatin ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim, në të cilin ka propozuar që të refuzohet prapsimi i debitorit në tërësi si i pabazuar dhe të vërtetohet urdhri për lejimin dhe caktimin e përmbarimit P.nr.680/19.

Gjykata në procedurë përmbarimore pas shqyrtimit dhe vlerësimit të prapësimin të debitorit, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi duke e pranuar pjesërisht si të bazuar prapësimin për shkak se borxhi i kërkuar nga kreditori deri me 31.12.2017 është i parashkruar dhe atë në shumë prej 298.60 € duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 360 par. 1 pika 1.1 dhe par. 2 të LMD-së (Ligji Nr. 04/L-077) i cili përcakton: *se kërkesat të cilat parashkruhen pas një viti janë kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake, ndërsa afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë.* Pala debitore në kuptim të dispozitave ligjore në fuqi të LMD-së është thirrur në parashkrimin e borxhit. Me dispozitën ligjore të nenin 71 të LPP-së është përcaktuar se: *sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: ka skaduar afati kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkohet përmbarimi,* me çka në rastin konkret është plotësuar kushti ligjor i paraparë me këtë dispozitë për të vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi. Ndërsa për pjesën tjetër të borxhit lëndor në shumë prej 113.40 € e cila përfshin periudhën kohore nga data 01.01.2018 e deri me datë 01.09.2019 obligohet pala debitore që t'ia paguaj kreditorit, kërkesë kjo e cila nuk është parashkruar, për shkak se afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë, pa marr parasysh nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë. Gjykata e refuzoi prapësimin e debitorit si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi sa i përket borxhit lëndor në shumë prej 113.40 € si të pabazuar në mungesë të provave materiale të cilat debitori nuk ia ka bashkangjitur prapësimin, ngase debitori nuk ka ofruar ndonjë dëshmi me të cilën vërtetohet se është përmbushur detyrimi sipas faturave për vitin 2018 dhe 2019, e duke ju referuar nenit 69 par. 4 të LPP-së i cili shprehimisht përcakton se: *baza për prapësim duhet të mbështetet në prova të duhura, provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet.*

Gjykata i analizoi dhe shqyrtoi edhe pretendimet e tjera të debitorit të ushtruar me prapsim kundër propozimit për përmbarim të kreditorit, mirëpo gjykata nuk ua fali besimin sepse nuk ishin të mbështetura në prova relevante e as pretendimet e theksuara në prapësim nuk ishin të argumentuara, e duke pasur parasysh faktin se debitori nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se i njëjti

ka paraqitur ndonjë ankesë ndaj kreditorit për faturën e lëshuar nga kreditori, gjykata ka gjetur se duhet vendosur si në dispozitat të këtij aktvendimi.

Me dispozitën ligjore të nenit 29 par. pika 1.2 të LPP-së është përcaktuar se përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm, e dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është edhe ekstrakti i verifikuar nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave e në bazë të cilit e ka mbështetjen ligjore urdhri për përmbarim.

Gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancën gjyqësore, duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 73 par. 1 të LPP-së i cili përcakton se: *gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përgjashtimisht gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit.*

Në pikën -III-, të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin, në rast se parashtrohet ankesë kundër këtij aktvendimi, në afatin prej 7 ditëve, në momentin e parashtrimit të ankesës të deponoi garancinë në gjykatë, në shumën e përcaktuar nga gjykata si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t'ia dorëzoi provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke iu referuar nenit 73 të LPP-së, e lidhur me nenin 245 par.1 dhe 2, të LMD-së.

GJYKATA THEMELORE PEJË- DEGA ISTOG

PPP.nr.176/2019 me datë 29.11.2023

G j y q t a r j a

Pajtesë Boshnjaku

UDHËZIMI JURIDK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të të njëjtit, përmes kësaj gjykate.